



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM
Nr. 509, Datë 02.05.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”;

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a), të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në datat 23 Mars dhe 20 Prill 2018, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, me qëllim vlerësimin e kushteve të tregtimit të këtij produkti dhe evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 4 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.

Nga monitorimi i realizuar, u vërejt se: sistemi elektronik online i shitjes së policave të sigurimit gjeneron polica vetëm të disa shoqërive të sigurimit, nga 8 shoqëri që operojnë

në këtë treg, duke mos u lejuar agjentëve zgjedhjen në sistem të shoqërive të tjera të sigurimit. Kjo situatë është e përsëritur duke shfaqur problematika për konkurrencën në treg.

Tregu i sigurimeve të detyrueshme motorike ka qenë objekt i vazhdueshëm i procedurave hetimore të Autoritetit të Konkurrencës të konkluduara me masa dhe detyrime për shoqëritë e sigurimit, si dhe rekomandime për AMF-në.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01 Janari 2017 deri në 30 Prill 2018.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS